

## **Programi i Zhvillimit të Qendrushëm të Zonave Malore Rurale (SDRMA) 2006- në vazhdim**

*Objektivi:* Të rrisë të ardhurat e ekonomive fshatare në zonat malore të Shqipërisë, veçanërisht midis popullsisë më të varfer rurale nepermjet përgatitjes dhe zbatimit me pjesëmarrje të një programi për zhvillimin rajonal të qendrushëm për zonat malore në Shqipëri qe pershpejton reduktimin e varferisë dhe rritjen ekonomike.

*Qëllimi:* Analizat e fundit konfirmuan dimensionet rajonale të varferisë në Shqipëri dhe sigurimi i justifikimit të mjaftueshëm për mirembajtjen e një fokusi të qarte të perpjekjeve të zhvillimit mbi rrethanat kërkesat dhe potencialet e veçanta të zonave malore. Ishte evidente një rritje e njohjes se kësaj kërkesë në një nivel programimi dhe planifikimi strategjik në Strategjine Kombetare të Zhvillimit Ekonomik - Social (NSSED) dhe e rëndësisë së krijimit të një angazhimi afatgjatë në drejtim të: (i) mobilizimit të investimeve nga sektori privat në zonën malore dhe nxitjen e investimeve të brendshme për të krijuar një rritje të qendrushme në punësim dhe të ardhura për reduktimin e varferisë; (ii) përshpejtimin e rritjeve proporcionale në alokimet e buxhetit kombëtar dhe politikave qeverisëse qe influencojnë në mbështetjen e perparimit të ekonomisë rurale në zonat malore; (iii) krijimin e një platforme të përmirësuar për terheqjen/mobilizimin e një financimi të jashtëm shtesë në interesat e këtyre zonave – veçanërisht në nivelin e rëndësishëm të fondeve të parashikuara nga BE të cilat kanë instrumentin financiar të veçante për zonat e pafavorizuara dhe malore.

Veprimet dhe rezultatet e programit të mëparshëm MADP të zbatuar nga MADA kanë pasur një efekt pozitiv të shoqeruara me: (i) kapacitetin e sipërmarjeve për të investuar në rinovimin e teknologjise;(ii) mardhënie biznesi të perforcuara midis paleve të ndryshme të përfshira në zinxhirin e furnizimit;(iii) nivele të mira të aktiviteteve lokale ekonomike si dhe (iv) nivele të mira të lidhjes popullore me proceset e zhvillimit. Efektet ilustruan influencën e MADA-s si pershpejtues të reduktimit të varferisë dhe rritjes ekonomike në këto zona.

Programi është akoma nën zbatim dhe po zhvillon aktivitete të cilat do të gjenerojnë përfitime në kategorite e mëposhtme: (i) mobilizimi me i mire i investimeve shtesë publike dhe private në zonën malore; (ii) ngritja i një numri më të madh biznesesh efektiveë për zhvillimin e zonës malore; (iii) gjenerim i punësimit sidomos për popullsinë më të varfer në zonën e programit veçanërisht për grate dhe të rinjte;(iv) racionalizimi i tregut të punës, transferimi i vfermerëve me aktivitet ekonomik në prodhime dhe shërbime dytesore (v) kapacitet me i larte në në qeverisjen lokale dhe njerezve për të planifikuar dhe zbatuar zhvillimin ekonomik.

SDRMA mbështet katër komponentë, tre do të realizohen nëpërmjet MADA-s dhe i katërti nëpërmjet MAFF-it. Komponentët qe zbaton MADA janë: (1) Zhvillimi i Programit Rajonal; (2) Zhvillimi i Sektorit Privat; (3) Implementimi në Terren dhe Testimi i Metodave të Investimit, si dhe një komponent mbështetes; Menaxhimi dhe Organizimi i Programit.

Kosto totale e ketij Programi eshte 24.2 Milion USD.

## **Programi « Malet Drejt Tregut », (MMP) - 2009 – në vazhdim**

*Objektivi:* Rritja e të ardhurat e familjeve të varfra të zonës së Programit dhe ka si objektiv reduktimin e varferisë rurale me përmirësimin e oportuniteteve të të varfërve rurale për pjesëmarrjen dhe punësimin në zinxhoret e furnizimit rural konkurrues dhe komercial përmes aksesit të rritur në tregjet, njohurive teknike dhe finances.

*Qëllimi:* pavarësisht nga një periudhë e gjatë e rritjes ekonomike ende qendron rasti që në vitin 2006, 18.5% e popullsisë jetonte në varferine absolute dhe 3.5% e popullsisë në varferi ekstreme dhe për më tëper varferia rurale përben 75% e varferisë totale.

Pershkrimi i Programit: Programi përfshin tre komponente: (i) Zhvillimi i tregjeve rurale; (ii) Infrastruktura në lidhjen me tregun (iii) Menaxhimi i programit. Programi do të zbatohet në rrethet Lezhe, Shkoder, Diber, Kukës

Kosto totale e këtij Programi është 17.9 Milion USD.